29108

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

Nr. 29108 vendimit

# V E N D I M

## PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot me date 19.02.2003 une gjyqtare e gjykates se shkalles se Pare Tirane Zegjine Sellaku mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Ismail Germani per rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " GERMANI " shpk dhe

## K O N S T A T O V A

Se kerkuesi kerkon rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " GERMANI " shpk me dy ortake z. Ismail Germani dhe Arben Germani me kohezgjatje per 10 vjet nekapital fillestar 100.000 leke me seli ne Durres lagja nr. 17 rruga P. Sorra nr. 680 me administrator z. Ismail Germani me objekt te veprimtarise ne fushen e tregetimit me shumice e pakice brenda dhe jashte vendit import eksport te mallrave industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, ndertimore, elektroshtepiake, hidrosanitare elektrike, drusore, pjese kembimi per autovetura e kamiona, bojra per lyerje hidraut e nitro. Prodhim tregetim me shumice e pakice brenda dhe jashte vendit import eksport te marmitave per autovetura e kamiona. Servis per mirembajtjen e autoveturave e kamionave per pjese xhenerike e motorike si dhe lyerjen e tyre.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 dhe te ligjit nr. 7667 date 28.01.1993

## V E N D O S A

RRegjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " GERMANI " shpk me dy ortake z. Ismail Germani dhe z. Arben Germani me seli ne lagjen nr. 17 rruga P. Sorra nr. 680 Durres, me kapital fillestar 100.000 leke me administrator z. Ismail Germani.

Me objekt te veprimtarise ne fushen e : tregetimit me shumice e pakice brenda dhe jashte vendit te import eksport te mallrave industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale ndertimore, elektroshtepiake, hidrosanitare, elektrike, drusore pjese kembimi per autovetura e kamiona, bojra per lyerje hidrant e nitro.Prodhimin , tregetimin, me shumice e pakice brenda dhe jashte vendit i,port eksport te marmitave per autovetura e kamiona.Servis per mirembajtjen e autoveturave e kamionave per pjese xhenerike e motorike si dhe lyerjen e tyre.

Kunder vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE

ZEGJINE SOLLAKU

# AKT - THEMELIMI

# I

# SHOQERISE ME PERGJEGJSI TE KUFIZUAR

# „ G E R M A N I „(sh.p.k.)

---

Do te krijohet nje shoqeri tregtare me pergjegjsi te kufizuar,nga vullneti dhe deshira e lire e themeluesvet te saj :

1.ISMAIL GERMANI;I biri Fejzullait,dtl.1961,banues ne Durres,lagja 17,rr „P.Sorra „ 680
2.ARBEN GERMANI,biri Fejzullait,dtl.1967,banues ne Durres,lagja 17,rr.P.Sorra

E cila ne veprimtarine e saj tregtare,ekonomike e prodhuese do te udhehiqet nga zbatimi I ligjit per shoqerite tregtare,nga Kodi Civil si dhe te gjithe aktet e normat juridike qe rregullojne mardhenjet e shoqerise me te trete e ndermjet tyre.

## Emertimi

---

Shoqeria e porsa krijuar do te emertohet "GERMANI"(sh.p.k
E cila do te jete me pergjegjsi te kufizuar ,dhe pergjigjet per humbjet e saj deri ne kufirin e kapitalit themeltar .

## S e l l a

---

Shoqeria tregtare "GERMANI"(sh.p.k.) seline e saj do ta kete ne Durres,lagja nr 17,rruga "P.Sorra"nr 680.
Njekohesisht qendren operative te saj do ta kete ne te njejtin vend,I cili mund te ndryshoje sipas objektit qe do te kete per

aktivitetin e saj shoqeria,duke hapur dege dhe filiale te saj ne te gjithe vendin si dhe jashte tij.

## Objekti I Veprimtarise

Objekti I veprimtarise se shoqerise do te jete :

Tregti me shumice e pakice,brenda dhe jashte vendit,import export te mallrave industriale,ushqimore,bujqesore,blegtorale,ndertimore,elektroshtepiake,hidrosanitare,elektrike,drusore,pjese kembimi Per autovetura e kamiona,bojra per lyerje hidrant e nitro.

Transport mallrash te ndryshem per vehte dhe te trete,brenda dhe jashte vendit,

Prodhim e tregtim me shumice e pakice,brenda e jashte vendit,import export te marmitave per autovetura e kamiona.

Servis,per mirembajtjen e autoveturave e kamionave per pjese xhenerike , motorike ,si dhe lyerjen e tyre.

## Kapitali I shoqerise

Kapitali themeltar I shoqerise do te jete lOO.OOO leke,I ndare ne 100 pjese teresisht te nenshkruara e te shlyera,duke patur sejcila prej tyre nje vlere nominale prej 1.000 leke.Fondet e ardhura nga derdhja ne para nga ortaket depozitohet prane Bankes Kursimeve Durres.Kontributet ne pjese e ne perqindje sipas ortakeve eshte :

1.Ismail Germani,lek 50.000,qe I takon 50 pjese ose 50% e kapitalit.

2.Arben Germani,lek 50.000,qe I takon 50 pjese ose 50% e kapitalit.

Ortaket perballojne humbjet e shoqerise vetem,deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themelues.

## Kohe zgjatja

Kohe zgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte per 10 vjet

E cila sipas vendimit te ortakut te vetem themelues te saj
Mund te shtyhet me tej ose mund te shperbehet ne cdo
Kohe simbas percaktimit te bere ne statutin e shoqerise.

## Administrimi I shoqerise

Organi vendimor I shoqerise eshte Asamblea e Ortakakeve.
Vendimet e saja te mara me shumice votash jane te detyrue-
-shme per ortaket.
Cdo ortak ka te drejte te mare pjese ne asamble,te paraqese
Mendimin e tij dhe te shpreh aq vota sa jane pjeset e kapi-
-talit te tij
Per drejtimin e puneve te shoqerise eshte caktuar dhe
Administratori unik I saj z.ISMAIL GERMANI.te drejtat
Dhe kompetencat e te cilit percaktohen ne statutin e shoqe-
-rise.

## Bilanci dhe te ardhurat

Viti financiar I shoqerise do te filloje me daten l Janar dhe
Do te perfundoje me daten 31 Dhjetor te cdo viti.
Bilanci vjetor do te nxirret nga ekspertet kontabel dhe do
Te miratohet nga Asamblea,e cila do te beje dhe mire
Administrimin dhe shperndarjen e fitimit.

## Zgjidhja e mosmareveshjeve

Ne se ne shoqeri do te lindin mosmareveshje ndermjet
Ortakeve,ndermjet tyre dhe te punesuarve,do te veprohet
Sipas kodit te Punes,nese nuk zgjidhen me mirekuptim.
Nga ky moment shoqeria "GERMANI"(sh.p.k.) do te quh
E themeluar,menyra e organizimit dhe e funksionimit te
Saj do te percaktohet ne statut si referenca ne ligjet e tjere.

ORTAKU THEMELUES

ISMAIL GERMANI

Arben Germani

# S T A T U T

# SHOQERISE ME PERGJEGJSI TE KUFIZUAR

# „G E R M A N I“

---

Mbeshtetu ne ligjin 7638 date 19.11.1992,“Per shoqerite tregtare“si dhe ne aktin e themelimit,personat fizike te meposhtem

1.ISMAIL GERMANI,I biri Fejzullait,I dtl.1961,banues ne Durres,lagja nr 17,rruga „P.Sorra“

2.ARBEN GERMANI;I biri Fejzullait,I dtl.1967,banuesne Durres,lagja nr 17,rruga“P.Sorra“

Kane rene dakort te nenshkruajne kete statut per themelimin e nje shoqerie me pergjegjsi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

## Formimi

### Neni 1

Eshte krijuar nje shoqeri me pergjegjsi te kufizuar nga vullneti Dhe deshira e lire e themeluesve te saj e cila do te rregullohet Nga ky statut dhe akti I themelimit te saj.Shoqeria do te veproje Sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

## Emertimi

### Neni 2

Shoqeria e porsa krijuar,sipas vendimit te mare nga te dy ortaket Themelues te saj do te emertohet „GERMANI“(sh.p.k.)

Kohe zgjatja

Neni 3

Veprimtaria ekonomiko-tregtare e shoqerise do te jete per nje afat Kohor 10 vjecar,I cili sipas vendimit qe do te mare asamblea e Shoqerise mund te shtyhet ose pakesohet ne perputhje me ligjin.

Selia

Neni 4

Seline e saj legale shoqeria do ta kete ne lagjen 17 Rr-P.Sorra nr. 680-
Qendra operative e saj do te jete ne adresen e mesiperme,por Shoqeria mund te hape filiale,dege ose perfaqesi te saj ne te Gjithe teritorin e shqiperise si dhe jashte shtetit,ne perputhje Me ligjen.

Objekti veprimtarise

Nerni 5

Objekti I veprimtarise se shoqerise do te jete I percaktuar sa me Poshte :

- Tregti me shumice e pakice,brenda dhe jashte vendit, Import export te mallrave,industriale,ushqimore,buj--qesore,blegtorale,ndertimore,elektroshtepiake,hidro--sanitare,elektrike,drusore,pjese kembimi per autove--tura e kamiona,bojra per lyerje hidrant e nitro.
  Transport mallrash te ndryshem per vehte dhe te trete -brenda dhe jashte vendit.
  Prodhim e tregtim me shumice e pakice,brenda dhe jashte vendit,import export te marmitave per autovetura e kamiona.
  Servis,per mirembajtjen e autoveturave e kamionave per pjese xhenerike e motorike si dhe lyerjen e tyre .

Kapitali I shoqerise

Neni 6

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000 leke,I ndare ne 100 pjese teresisht te nenshkruara e te shlyera,duke patur sejci- -la prej tyre nje vlere nominale prej 1000 leke.Fondet e ardhura nga derdhja ne para nga ortaket depozitohet prane Bankes_____, ne llogari te vecante ne emer te shoqerise.

Kontributet ne pjese e perqindje sipas ortakeve,eshte sa me po- -shte :

1.ISMAIL GERMANI,lek 50.000,I takon 50 pjese ose 50% e kapitalit

2.ARBEN GERMANI,lek 50.000,I takon 50 pjese ose 50% e kapitalit.

Ortaket perballojne humbjet e shoqerise vetem deri ne Kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themelues.

Neni7

Kapitali themeltar mund te shtohet pa kufi,ne cfardo momenti,nje Ose shume here,me vota te shprehura ne asamblene e ortakeve,te Pranishem ose qe perfaqesojne a zoterojne ¾ e kapitalitthemeltar.
E njejta procedure eshte dhe per zvogelimin e kapitalit te shoqeris
Ne rastet e shtimi a zvogelimit te kapitalit ortaket kane te drejten E nenshkrimit te tyre ne raport me kapitalin qe zoterojne.

Neni8

Pjese mund tu transferohet te treteve teresisht ose pjeserisht ve- -tem me vendim te asamblese se ortakeve qe zoteroje 3/4 e kapi- -talit themeltar.

Ne cdo rast pjeset duhet tu afrohen me perparesi ortakeve,vetem Ne rast se ata heqin dore,do tu kalohet te treteve,me kusht qe Transferimi te mos jete me I leverdisshem per bleresin ne raport Me ato te propozuara ortakeve.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegi-

-mie.

Administrimi I shoqerise

Neni 9

Organi vendimor I shoqerise eshte Asamblea e ortakeve.Vendi- -met e saj te mara nga shumica e votave jane te detyrueshme per te gjithe ortaket.

Cdo ortak ka te drejte te mare pjese ne asamble,te paraqese men- -dimin e tij dhe te shpreh aq vota sa jane pjeset e kapitalit te der- -dhur nga ai.

Neni 10

Asamblea e ortakeve eshte organi me I larte drejtues I shoqerise. Ajo perbehet nga teresia e pjeseve qe zoterojne ortaket e shoqeri- -se nga kapitalet e derdhura prej tyre.

Asamblea eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme,e cila eshte E tille kur ajo eshte e shprehur ne thirrjen e bere nga administra- -tori,sipas kompetemcave qe ka ajo mbledhje.

Neni 11

Te drejten e thirjes se asamblese e kane

Administratori

Nje nga ortaket e shoqerise

Likujdatori.

Te cilet shprehin vendin ,daten,oren,rendin e dites qe do te zhvi- Llohet si dhe materialet perkatese te mbledhjes.

Neni 12.

Asamblea e zakoneshme thirret se paku nje here ne vit,brenda 30 diteve nga mbyllja e vitit ushtrimor per aprovimnin e bilan- -cit te relacioneve te administratorit,te ekspertit kontabel ,

per inventarin, dhe mbi shperndarjen e fitimit.

Asamblea e jashtezakoneshme mblidhet jo me pare se 3 muaj Nga data e meparshme e mbledhjes se asamblese.

Neni 13

Asamblea e jashtezakonshme vendos per :
Ndryshime ne aktin e themelimit e statutin e shoqerise
Mbi krijimin e filialeve dhe perfaqesive te shoqerise,brenda
Teritorit te R.Sh.si dhe jashte saj.
Mbi shtimin e zvogelimin e kapitalit te shoqerise.
Mbi zhvillimin e veprimtarive te reja dhe marjes persiper te te tyre.
Mbi transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar
Mbi emerimin dhe revokimin e likujdatoreve
Per cdo vendim te asamblese se jashtezakoneshme eshte e do--mosdoshme ¾ e pjeseve te kapitalit.

Neni 14

Cdo asamble drejtohet nga administratori.Vendimet e saj duhet
Te hidhen ne proces verbal,te nenshkruhen prej ortakeve.
Sa nuk eshte percaktuar plotesisht kompetencat e asamblese I
Referohen zbatimit te ligjeve te vecanta qe rregullojne keto mar-- dhenje

Emerimi I administratorit

Neni 15

Administratori I shoqerise „GERMANI"(sh.p.k.)eshte emeruar
Zoti ISMAIL GERMANI.Emerimi dhe revokimi I te cilit behet
Sipas vendimit te asamblese se ortakeve.

Administratori ka te gjithe fuqite per miradministrimin e zakon--shem e te jashtezakonshem te shoqerise,qe perfshihen ne objek--tin e veprimtarise,me perjashtim te atyre qe statuti ja rezervon
Asamblese.

Eksperti kontabel te autorizuar

Neni 16

Kontrolli I bilancit te vitit ushtrimor dhe te librave kontabel te Shoqerise do ti besohet nje eksperti kontabel te autorizuar,I eme- -ruar per nje vit,I rizgjedhshem nga ortaket qe perfaqesojne mbi 50 % te kapitalit,njekohesisht I revokueshem ne cdo kohe kur konsta- -tohet se nuk ka plotesuar detyrat e ngarkuara.

## Viti financiar e bilanci vjetor

Neni 17

Viti financiar fillon me daten 1 Janar dhe mbaron me date 31 Dhjetor te cdo viti ushtrimor te veprimtarise.
Aprovimi I dokumentave qe kane te bejne me vitin ushtrimor Do te behet brenda 30 diteve nga mbyllja e vitit financiar.

## Fitimet

Neni 18

Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci vjetor,pasi zbriten rezervat Ligjore dhe shumat tjera te percaktuara nga asamblea,pjesa e Mbetur u shperndahet ortakeve ne raport me pjeset e kapitalit the -meltar qe posedon sejcili ortak.

## Likujdimi

Neni 19

Ne rastin e prishjes shoqeria I nenshtrohet likujdimit.Per te Drejtuar kete procedure asamblea emeron nje ose disa likuj-

-datore,te cilet do te prezantojne relacionin perfundimtar mbi gjendjen e aktivit e pasivit te shoqerise,mbi veprimet e likuj- -dimit dhe afatet e domosdoshme qe duhen per te perfunduar procesin e likujdimit.

## Zgjidhja e mosmareveshjeve

Neni 20

Te gjithe mosmareveshjet qe lindin ne shoqeri,si gjate aktivitetit,

Ashtu dhe ndermjet ortakeve si dhe ketyre me te punesuarit,ne
Se nuk zgjidhen me mirekuptim,jane te detyruar ti zgjidhin ne
Gjykate,ne juridiksionin e te cilit kryen aktivitetin shoqeria.
Persa nuk eshte shprehur teresisht ne kete statut,I referohet ligjes
Perkatese per zgjidhjen e ceshtjes konkrete.

Neni 21

Ky statut eshte perpiluar ne disa kopje duke I lene nga nje prej
Tyre organeve perkatese.

ORTAKET

ISMAIL GERMANI

Arben Germani

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
Nr.rep 614
Nr.kol. -

VERTETIM

Sot me daten 12.02.03 (dymijetre)u paraqiten para meje noterit M. Mucati-,zoterinjte :
ISMAIL GERMANI, I biri Fejzullait,I dtl.02.05.1961, Banues ne Durres,lagja nr 17,rruga „P.Sorra“,nr.pasaportes__________
ARBEN GERMANI,I biri I Fajzullait,I dtl. 22.02.1967,banues ne Durres,lagja nr 17,rruga“P.Sorra“,me nr pasaporte_____________qe te dy madhore,me zotesi te plote per te vepruarme deshiren dhe vullnetin e tyre te lire,nenshkruan para meje noterit aktin e mesiperm dhe une vertetoj nenshkrimet e tyre sipas ligjes:

NOTER
Merita Mucati-

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
REGJISTRI I SHOQËRIVE TREGTARE

# URDHËR REGJISTRIMI

| | |
|---|---|
| Kolona I | Numri i Regjistrit Tregtar: 29108 |
| Kolona II | A. Emri i Shoqërisë: "Germani" sh.p.k<br>B. Selia: Rr. "P. Tona", Durrës, L.17.<br>C. Objekti: Tregti me shumicë e pakicë të mallrave industriale ushqimore, bujqësore etj<br>D. Kapitali: 100000 (njëqind mijë) lekë |
| Kolona III | A. Ortakët Ismail Germani<br>Arben Germani<br><br>B. Administratorët: Ismail Germani, i biri Fejzullait, dtl. 1961, banues në Durrës, L.17, Rr "P. Tona" |
| Kolona IV | Kohëzgjatja: 10 vjet |
| Kolona V | Shënime mbi aktet e shoqërisë:<br>A. Data e Nënshkrimit: 12.02.2003<br>B. Data e regjistrimit: 19.02.2003<br>C. Statuti fletë: 8 (tetë)<br>D. Akti i Themelimit fletë 4 (katër) |

*Shënime:* Shuma prej 100.000 lekë është depozituar pranë Bankës së Tiranës me dt 10.02.2003

GJYQTARE